



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Mars 2022

Nr: 114

V E N D I M

P Ë R

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DY QENDRAVE  
TË VOTIMIT NË BASHKINË SHKODËR, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE  
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 3403 prot., datë 1.3.2022, kryetari i bashkisë Shkodër ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së 2 (dy) qendrave të votimit të bashkisë Shkodër.

Në shkresën e dërguar bashkia referon se, vendndodhja e QV nr. 0272 dhe 0272/1 të vendosura në qendër shëndetësore nr. 2, duhet të zhvendosen pasi në ambientet e qendrës shëndetësore janë të vendosura pajisje të shtuara mjeksore dhe e bën të pamundur ambjentin për të shërbyer për QV, duke kërkuar zhvendosjen e tyre në shkollën “Dëshmorët e Prishtinës”. Këto dy qendra votimi kanë qenë të vendosura në këtë shkollë edhe në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021.

Gjithashtu, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 5, shpreh në mënyrë unanime nëpërmjet kërkesës së tij, drejtuar KQZ dhe bashkisë Shkodër, dakortësinë për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit.



Data: 1 Mars 2022

Nr. 114

“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së dy qendrave të votimit në bashkinë Shkodër, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 0272 dhe QV nr. 0272/1, nga Qendra Shëndetësore në shkollën “Dëshmorët e Prishtinës”, bashkia Shkodër.
2. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë njoftimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e dy qendrave të votimit, të caktuar me këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

